

Vendim nr. 169, datë 28.05.2026

V E N D I M

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 28.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (Sh) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “BAJRAMI N” SH.P.K.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3516, datë 15.10.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik, me objekt të veprimtarisë së saj tregtare punime zbatuese ndërtimi, e pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Ndërsa shoqëria “Copri-Aktor” është person juridik i krijuar si shoqëri e thjeshtë, e cila ka lidhur kontratë me Autoritetin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë përsipër ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan, Segmenti 1.

2. Të dyja shoqëritë kanë lidhur me njëra-tjetrën pesë kontrata/aktmarrëveshje nga viti 2012 deri në vitin 2014, që kanë sjellë detyrime juridike civile për të dyja palët. Në këto aktmarrëveshje, shoqëria “Copri-Aktor” ka qenë në cilësinë e kontraktore, ndërsa kërkuesja ka qenë në cilësinë e nënkontraktore.

3. Kërkuesja ka pretenduar se shoqëria “Copri-Aktor” (në cilësinë e kontraktore) ka pasur detyrimin kontraktor, sipas nenit 3 të secilës kontratë, për të bërë pagesën sipas çmimeve përkatëse. Sipas kërkueses, kontraktorja/shoqëria “Copri-Aktor” nuk i ka bërë të plota pagesat sipas aktmarrëveshjeve të sipërcituara, në shumën totale 976.016 USD. Ndërkohë, sipas kontraktore është paguar shuma 791.736 USD dhe ka mbetur për t’u paguar detyrimi në shumën 184.280 USD.

4. Në këto rrethana, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt: i) detyrimin për pagesën e shumës 184.282,25 USD si dëm efektiv, detyrim kontraktor i papërbushur; ii) detyrimin për pagesën e shumës 23.458,16 USD, si kamata ligjore, për shkak të vonesës në pagesën e vlerës 184.282,25 USD, deri në datën 13.09.2016 dhe pas datës 13.09.2016, për çdo ditë vonesë, detyrimi për të paguar kamatëvonesën 29,02 USD/ditë, deri në momentin e zbatimit të vendimit gjyqësor; iii) detyrimin për pagesën e shumës 761.250 lekë si dëm efektiv për faturat e pranuar dhe të palikuiduara; iv) detyrimin për pagesën e shumës 46.312,81 lekë si fitim i munguar për shkak të vonesës në pagesën e shumës 761.250 lekë, deri në datën 13.09.2016 dhe pas datës 13.09.2016, pagesën e kamatëvonesës 27,48 lekë/ditë, deri në momentin e zbatimit të vendimit gjyqësor.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9397, datë 21.11.2016, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë “Copri-Aktor” për të paguar shumën 761,250 lekë, si edhe kamatat ligjore për shkak të vonesës për këtë shumë, të përlllogaritura nga ekspertja deri në datën 13.09.2016 në shumën 46,312.81 lekë, dhe pas datës 13.09.2016 kamatëvonesat në shumën 27.48 lekë/dite, deri në momentin e zbatimit të vendimit gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se shoqëria “Copri-Aktor”, në cilësinë e blerëses, e ka pranuar mallin dhe ka nënshkruar faturën që e shoqëronte atë. Për rrjedhojë, ajo

është e detyruar të përmbushë detyrimin kontraktor që buron nga furnizimi me artikullin “çimento”, të dokumentuar me gjashtë fatura tatimore. Ndaj vendimit kanë paraqitur ankim edhe kërkuësja, duke kërkuar pranimin tërësisht të kërkesëpadiës, edhe shoqëria “Copri-Aktor”.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1416, datë 26.05.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 9397, datë 21.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Apelit, vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i bazuar në ligj e në prova. Sipas gjykatës së apelit, gjykimi është zhvilluar me shkelje procedurale, që e bëjnë atë të pavlefshëm, sepse në mënyrën sesi është formuar ndërgjyqësia në këtë gjykim është e gabuar dhe cenon rregullshmërinë e gjykimit. Si kërkuësja/paditësja, ashtu edhe gjykata kanë gabuar kur kanë vlerësuar se “Copri-Aktor” është person juridik, pasi sipas ekstraktit të datës 7.12.2015 të marrë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ka rezultuar se në fakt është “shoqëri e thjeshtë”. Gjykata e apelit ka vlerësuar se shoqëria e thjeshtë në të drejtën shqiptare nuk është e pajisur me personalitet juridik, që do të thotë se nuk përbën një entitet të pavarur nga anëtarët që e kanë krijuar atë. Ndaj vendimit kanë ushtruar rekurs të dyja palët ndërgjyqëse. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3516, datë 15.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve pasi ato janë bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sipas formulimit që ka pasur në kohën e paraqitjes së rekursit.

7. Kërkuësja në datën 24.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuësës

8. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:
 - 8.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk e ka zgjidhur çështjen në themel. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk respekton standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi paraqitet i mangët dhe nuk ofron arsyetim minimal, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Gjykata e Lartë praktikisht ka mohuar shqyrtimin efektiv të

rekursit. Çështja, duke u rikthyer për gjykim, ka krijuar një zgjatje shumë joproporcionale duke u cenuar edhe siguria e besimi në drejtësi. Për shkak të interpretimit të bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për pozitën procedurale të shoqërisë kontraktore, kërkueses i është vështirësuar mbrojtja e së drejtës subjektive që buron nga kontrata. Gjykata nëse eventualisht vendos shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë do ta detyrojë këtë të fundit të shqyrtojë themelin e çështjes dhe të shprehet vetë për legjitimimin e shoqërisë “Copri-Aktor”.

8.2. Gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm ligjor, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin pas tetë vjetësh nga regjistrimi duke dhënë një vendim për mospranimin e rekursit. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë ka krijuar një disproporcionalitet të dukshëm procedural, duke e bërë të drejtën e kërkueses për rekurs praktikisht jo efektive.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të legjitimitit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet

mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

11. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Kontrolli kushtetues ka funksion subsidiar, ndaj mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i të drejtave kushtetuese mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtëjshëm të të drejtave (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se objekt kundërshtimi në Gjykatë është vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesja dhe pala tjetër ndërgjyqëse (shoqëria “Copri-Aktor”) ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë që ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar *të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *të drejtën për t’u gjykuar tej afatit të arsyeshem*.

13. Nga analiza e këtyre rrethanave, Kolegji evidenton se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, që ka kthyer çështjen për rigjykim, nuk konsiderohet përfundimtar, për efekte të gjykimit kushtetues. Në të tilla raste, Gjykata ka pohuar se kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 9, datë 11.02.2026; nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Sistemi gjyqësor është një sistem korrigjues subsidiar, i cili, nga mënyra sesi është ndërtuar dhe funksionon, u përgjigjet të gjitha pretendimeve për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore dhe individit ka mundësinë që në çdo hallkë, fazë ose shkallë të procesit, të ngrejë pretendime konkrete. Gjykatat e zakonshme, duke pasur kompetencën për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve ligjore të qytetarëve, janë në pozicionin e duhur për të filluar dhe, nëse është e nevojshme, për t’i dhënë forcë detyruese

interpretimit kushtetues që mbron të drejtat themelore (*shih vendimin nr. 9, datë 11.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nuk mund të merren në shqyrtim, pasi vendimi gjyqësor i kundërshtuar nuk është përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues.

14. Në lidhje me pretendimin për shqyrtimin e rekursit tej afatit të arsyeshëm, dispozitat e KPC-së, që kanë hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2017, parashikojnë mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, në këto dispozita përcaktohet kuptimi i afateve të arsyeshme (neni 399/2), mjetet e mbrojtjes nga cenimi, kërkesa për përsheptimin e gjykimit (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe kuptimi i shpërblimit të drejtë (neni 399/3), përcaktohet gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe pse kërkesja ka pretenduar *kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit gjyqësor*, nuk rezulton që t'i jetë drejtuar gjykatës kompetente, në këtë rast Gjykatës së Lartë, me kërkesë për konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6 të KPC-së.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.